



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 23 shtator 2019

Z. Burim Berisha, Kryetar
Komuna e Fushë Kosovës

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 203/2019
kundër
Komunës së Fushë Kosovës

I nderuari z. Berisha,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQPD),¹ më 4 mars 2019, ka pranuar ankesë nga z. F.M., parashtruar kundër Komunës së Fushë Kosovës, për shkak të pamundësisimit për qasje në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka në dispozicion Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), ankuesi, më 19 dhjetor 2018 dhe më 16 janar 2019, i është drejtuar Drejtorisë për Planifikim Urban (DPU) e Komunës së Fushë Kosovës, me kërkesë për qasje në procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investues, i datës 30 shtator 2014, në bazë të të cilit është nxjerrë Aktvendim 06. nr.300, i datës 23.10.2014; si dhe në projektin kryesor dhe projektin bazë (bodrum) sipas Lejes urbanistike 06.nr.233, e datës 19.7.2012, dhe Lejen ndërtimore nr. 06/235, e datës 25.7.2012.

Më 25 janar 2019, ankuesi ka marrë një njoftim nga zyrtari për qasje në dokumente publike i Komunës së Fushë Kosovës, përmes të cilit është njoftuar: “[...] *Kjo drejtori e ka në shqyrtim kërkesën në fjalë. Deri më tani ne i kemi dorëzuar të gjitha dokumentet-kopjet e kërkuara nga pala përveç projektit kryesor i cili së bashku dhe një pjesë të madhe të dokumentacionit teknik për shkak të mungesës së hapësirës nuk janë transferuar në objektin e ri ... [...] Në lokacionin ku gjenden ato ne e kemi të pamundur të kemi qasje. Por ne do të tentojmë gjatë javës së ardhshme të kërkojmë nga investitori të na mundësoj kopjen e bazës së bodrumit(sipas kërkesës së palës) dhe do t’ju njoftojmë për përgjigjen e tij... [...]” Pavarësisht premtimit të dhënë në njoftimin e 25 janarit 2019, ankuesit nuk i është mundësuar qasja në dokumentet e kërkuara edhe pas më shumë se 2 muajsh. Ai i është drejtuar IAP-së më 4 mars 2019.*

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e drejtuar nga ankuesi është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

Avokati i Popullit, më 15 prill 2019, i është drejtuar me shkresë kryetarit të komunës së Fushë Kosovës, duke kërkuar prej tij informata për veprimet që i ka ndërmarrë Komuna apo për ato që planifikon t'i ndërmarrë, në mënyrë që t'i përgjigjet ankuesit në kërkesën për qasje në dokumente publike. Meqenëse Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje në këtë shkresë, IAP-ja, më 16 maj 2019, nëpërmjet postës elektronike, ka kontaktuar me zyrtarin për informim i Komunës së Fushë Kosovës. Më 17 maj 2019, IAP-ja ka marrë përgjigje nëpërmjet postës elektronike, përmes së cilës është njoftuar me të njëjtat përgjigje që Komuna e Fushë Kosovës ia kishte përcjellë ankuesit më 25 janar 2019. Më 1 gusht 2019, Avokati i Popullit i është drejtuar përsëri me shkresë kryetarit të komunës së Fushë Kosovës, përkitazi me ankesën, por nuk ka marrë përgjigje.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike, sipas të cilit definohet: *“Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.”*

Paragrafi 2 i po të njëjtit nen të Kushtetutës përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet janë të qasshme për të gjithë, me përjashtim të atyre dokumenteve qasja në të cilat është e kufizuar me ligj: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”*

E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”*

Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”*

Për më tepër, Kushtetuta, në nenin 52, paragrafët 2 dhe 3, përcakton përgjegjësinë për mjedisin jetësor: *“Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.”*; dhe: *“Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.”*

Ndërsa Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 6, paragrafi 12, përcakton: *“Parimi i qasjes së publikut në informata. Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje.”*

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke proklamuar parimin e administratës së hapur, në nenin 9, paragrafi 1, parasheh: “*Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.*”.

Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara me LQDP-së. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin e ankuesit, Komuna e Fushë Kosovës ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e cila e drejtë është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq më vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës për përdorim të mjeteve juridike.

Obligimi ligjor për bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Fushë Kosovës, përveçse ka dështuar në përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41 dhe neni 132, paragrafi 3), po ashtu ka dështuar edhe në përmbushjen e obligimeve që burojnë nga LQDP-ja dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit (neni 25), në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet e kanë për obligim që t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative, duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyr në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të të drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i

REKOMANDON

Komunës së Fushë Kosovës

- ***Ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t’i përgjigjet atij, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.***
- ***T’i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit